DRTK SHKODËR
SEKTORI I ARKITEKTURËS

MIRATOHET
Sekretari i KKTKM
Endri Haxhiu

RELACION TEKNIK

MURI ANTIK RRETHUES NGA KULLA GJYSËM RRETHORE E ANËS JUGORE TË FORTIFIKIMIT TË LISIT DERI TEK PORTA E GRAVIARIT DHE AMBIENTET NË PJESËN E QYTETIT TË MESËM TË LISIT, LEZHË



GUSHT 2026

PËRMBAJTJA :

Hyrje *3*

Vendodhja *4*

Të dhëna hisotirike dhe përshkrimi arkitektonik *5*

Gjendja aktuale *8*

Problematika dhe ndërhyrje *11*

Bibliografia *13*

Hyrje

Objekt i këtij projekti restaurimi janë fragmente të murit antik të Lisit, Lezhë.
Hartimi i projektit fillon me kërkimin historik, konsultimi i materialeve historike, studimi i ndërhyrjeve restauruese të mëpërparshme, studimi i rilevime ndër vite etj. Kjo fazë është e rëndësishme për të ndërtuar kronologjinë historike të monumentit, dokumentimin e ndërhyrjeve restauruese, si dhe evidentimin e zonave ku ka ende vend për ndërhyrje në projektet e tjera. Puna kërkimore është pasuar nga rilevimi fotografik, rilevimi gjeometrik duke bërë të gjitha matjet e nevojshme për të kaluar pastaj tek rilevimi arkitektonik.
Rilevimi gjeometrik ndihmon në vizatimin e saktë të fragmenteve të murit; tipologjinë dhe karakteristikat ndërtimore. Një rilevim arkitektonik i kujdesshëm dhe evidentim sa më i detajuar i degradimeve do ndihmojë për hartimin e një projekti restaurimi sa më të plotë.
Materiali është i organizuar si më poshtë: pjesa që i përket studimit historik të mureve të Lisit, përshkrimi arkitektonik, për të vazhduar me problematikat, ndërhyrjet, specifikimet e ndërhyrjeve restauruese.

Vendodhja

Muret e Qytetit Antik Lis janë monument i Kategorisë së parë I-rë me vendim Nr. 586 datë 17.03.1948 aprovuar me ligj Nr. 609, date 24.05.1948.



Fig 1. *Harta e Shqipërisë, evidentimi i qarkut Lezhë*



Fig 2. *Ortofoto*

Të dhëna historike dhe përshkrimi arkitektonik

Qyteti i Lezhës shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë midis ultësirës së Shkodrës dhe bregut të Mates. Distanca rreth 55 km nga Tirana dhe rreth 35 km larg Shkodrës e bën atë sot një qendër të rëndësishmë transite. Që në antikitet qyteti njeh dy periudha historike të rëndësishme dhe njihet respektivisht si *Lissos* në periudhën helene, dhe *Lissus* në periudhën romake. Gjithashtu qyteti ka edhe kalanë e tij, e cila është e ngritur në formë katërkëndëshe mbi një kodër shkëmbore në lartësi rrëth 200 m.
Përsa i përket krijimit të qytetit, mund të përmblidhet në tre faza krijimi i qytetit të Lezhës:

1. – Krijimi i një vendbanimi të hapur vendosur bë një terren fushor

2. – Zgjedhja e një vendstrehimi të mbrojut nga natyra dhe forifikimi i tij

3. – Ndërtimi i qendrës protourbane të vendosur në maje të kodrës dhe fortifikimi i saj me mure rrethuese.



Fig 3. *Plani i Lisit*
Burimi: Edmond Malaj, *Lezha gjatë periudhes së Antikitetit*, f. 9.

Qyteti i Lisit u themelua në vitin 385 p.e.s nga Tirani i Sirakuzës Dionisi I mbi një vendbanim të fundit të fortifikuar të periudhës së hekurit të parë. Nuk ka të dhëna të sakta se për sa kohë funskioni si ngulim Sirakuzian, por në vitet 213/168 p.e.s Lissi shfaqet si rezidencë e mbretërve ardianë.



Fig 4. *Lis, Rilevimi 1:500 i azhornuar*
Burimi: Apollon Baçe, *Arkitektura në Iliri parë si refleks si strukturës sociale dhe botës shpirtërore*, f. 186.

Puna kërkimore në këtë sit arkeologjik për nxjerrjen në dritë të gjurmëve të mureve rrethuese si dhe një përcaktim i detajuar topografik i zonës së qytetit antik, daton që në ekspeditat 1968-69.

Përshkrimi arkitektonik

Struktura ushtarake e tregon Lisin një qytet tipik shpati me një sistem mbrojtjeje prej 4 muresh të tërthorta (diateihisma) të cilat krijojnë 4 breza mbrojtjeje: Akropolin që përkon me qytezën e hekurit të parë(2.3 ha), qytetin e sipërm (11 ha), qytetin e poshtëm (9 ha) dhe skelën breglumore që shërbente si port ushtarak dhe civil si edhe treg i jashtëm (1.5 ha). Krahas skelës lumore, qyteti kishte edhe skelën e tij detare Nimfeun ose Shën Gjini sot.

Muret mbrojtëse të qytetit rrethojne një sipërfaqr prej 22.3 ha (fig. 4).
Në sistemin e fortifikimit të Lisit antik bie në sy prania e portave të shumta ku deri më sot janë shënuar 10 të tilla ku 8 prej të cilave janë te jashtme dhe 2 të brendshme. Nga konfigurimi ato paraqiten si më të thjeshtat e fortifikimeve iliro-epiriote. Për ndërtimin e mureve antike të Lisit janë përdorur gurë që janë nxjerrë nga gurore të hapura brenda territorit të banimit dhe janë gurë gëlqerorë. Muret mbrojtëse ngrihen mbi tokë të fortë ose mënyra tjetër është ajo direct mbi shtresa shkëmbore. Gurët janë të vëllime të ndryshme dhe kanë të prerë në përgjithësi faqen e jashtme në formë trpaezoidale të çrregullt. Në themel janë vendosur gurë të zgjedhur me sipërfaqe të madhe mbështetëse dhe trashësi relativisht të vogël në krahasim me blloqet e muraturës. Vendosja e tyre është bërë bri njëri – tjetrit dhe kanë të gdhendur vetëm pjesen e sipërme të tyre. Në zonat ku terreni ka pjerrtësi të theksuar, themeli është ndërtuar me shkallëzime ku gjatësia lineare e shkallëzimit varet nga pjerrtësia e terrenit. Gjithashtu, vërehet që këto gurë të vendosur në themel janë të gdhendur me një profil të dhëmbëzuar në faqen e tyre ballore me qëllim parandalimin e rrëshqitjes së murit. Karakteristikë tjetër është se themeli nuk ndërtohet në të gjithë gjërësinë e murit, por vetëm në pjesën ku mbështeten faqet e murit dhe pjesa qëndrore e tij ose bërthama nuk ka fare themel. Muratura është një murature e thatë pa përdorur ndonjë material lidhës dhe gurët janë vendosur nga ana e tyre më e gjatë dhe në rreshta afëersisht horizontale. Dhëmbëzimet e pranishme të madhësive të vogla në disa raste i japin fugatimeve gjatësore drejtim të valëzuar. Muratura është e spostuar 10-12 cm më brënda faqes së jashtme të themelit. Lidhja e dy faqeve të murit asaj të jashtme dhe të brendshme me bërthamën realizohet nga vendosja në drejtim tërthor me gjatësinë e murit të blloqeve të gjata. Këto blloqe dallohen edhe në pjesën ballore të mureve nga sipërfaqja e vogël e tyre dhe nga brinjët anësore më të gjata se ato horizontale.



Fig 5. *Foto e murit*

Gjendja aktuale

Muret antike duke qënë se janë të ndërtuara me gurë të latuar dhe nga vendosja e zgjuar e tyre gjatë ndërtimit kanë ardhur në gjendje të mirë deri në ditët tona. Nuk vërehen me sy të lirë prania e frakturave. Përsa i përket konfigurimit të murit në tërësi duhet thënë se ai ruhet jo i plotë dhe vende–vende ruhet vetëm si gjurmë themeli. Lartësia e pjesëve të mureve që ruhen edhe sot variojnë nga 1.00 m deri në 3.50 m.



Fig 6. *Foto e murit të anës veriore*



Fig 7. *Foto e murit të anës veriore*



Fig 8. *Foto e murit të anës veriore*



Fig 9. *Foto e murit të anës veriore*



Fig 9. *Foto e murit të anës veriore*

Problematika dhe ndërhyrje

Një ndër shkaqet e humbjes së vazhdimësisë të materialit gur është edhe mungesa e materialit lidhës. Me kalimin e kohës pjesa e bërthamës së mureve janë mbushur nga permbytjet me materiale argjilore, dhera, bimësi etj. Vetë këto materiale të huaj për muraturën ushtrojnë presion mbi muret duke i zhvendosur ato nga pozicioni fillestar, dhe rrjedhimisht kemi dhe spostimin e gurëve siç janë edhe sot.
Problem tjetër është edhe bimësia e pranishme si në te gjithë gjatësinë e mureve ashtu edhe në pjesën midis tyre, pa harruar dhe ndërhyrjet që mund të jenë bërë nga vetë dora e njeriut.

Fragmenti i blloqeve antike ku është parashikuar të ndërhyhet shfaqet pjesërisht i dëmtuar, me rënie të blloqeve antike nga fragmentet e murit, si dhe nga prania e vegjetacionit të shumtë që dëmton muret dhe zonën përreth tyre. Vërehet se mbushja e murit është bërë me dhe dhe ka shume pak preence cakulli apo guresh, gjë që kanë shkaktuar tensione tek muratura antike.
Punimet restauruese të parashikuara kanë për qëllim rivendosjen e blloqeve të gurëve që janë rrëzuar konkretisht në ringritjen e 27 blloqeve të rrëzuar dhe risistemimin e 37 blloqeve në total të strukturës së murit, duke dhënë kështu një kuadër sa më të plotë viziv të mureve antike. Ripozicionimi i gurëve të rrëzuar do të bëhet me teknikën e anastilozës, në vendin ku ato kanë rënë dhe mbushjen e hapësirës midis mureve me dhe. Gjithashtu do të bëhet dhe pastrimi nga bimësia.
Ne momentin e ringritjes se blloqeve antike duhet te kihet parasysh rendi me te cilen do te kryhen veprimet. Si fillim do te montohet rreshti i pare io blloqeve antike duke filluar nga niveli i tokes, me pas do te behet mbushja me dhe. Keshtu me rradhe do te vendosen rreshti i dyte i blloqeve antike , do te behet mbushje e me pas montimi i rreshtit te trete te blloqeve antike. Keshtu veprohet per te gjithe rreshtat e mbetur deri ne kthimin ne gjendje fillestare te strukturese se mureve rrethues antike te qytetit te Lezhes.Ne vendosje e gureve ne zemren e murit (mbushjes se zemres) duhet te kihet parasysh qe qendra e rendeses te jete mesi i murit 3.5 m te gjere.
Ndërhyrja në ambientet e qytetit të mesëm të Lisit konsiston ne ringritjen e 37 blloqeve antike të rrëzuar ne tetor ne vitit 2020 si dhe në pastrimin e vegjetacionit.



Fig 10. *Fletë nga projekti i restaurimit*



Fig 11. *Fletë nga projekti i restaurimit*



Fig 12. *Fletë nga projekti i restaurimit*



Fig 13. *Fletë nga projekti i restaurimit*

Bibliografia

Baçe, A. (2017), *Arkitektura në Iliri parë si refleks si strukturës sociale dhe botës shpirtërore*, Tiranë, Kristalina-KH, f. 183-186.

Malaj, E. (2017) "Lezha gjatë periudhës së Antikitetit", Studime Historike, 3-4, f. 5-30.

“Muret Antike”. Revistë. Monumentet. 55/2016. Instituti i Monumenteve të Kulturës, f. 56-59.

Zheku, K. (1974) "Restaurimi i portës së Brendshme në qytetin Ilir të Lisit", monumentet, 7-8, f. 7-21.

Punoi:

Elson Laqja

Sabrina Kuçi

Fatjon Mlloja

Miratohet :

Petrit Bilali

Drejtor

Helidon Sokoli

Elson Laqja — Digitally signed by Elson Laqja — Date: 2026.09.02 13:34:19 +02'00'

Fatjon Mlloja — Digitally signed by Fatjon Mlloja — Date: 2026.09.02 13:34:55 +02'00'

Sabrina Kuci — Digitally signed by Sabrina Kuci — Date: 2026.09.02 14:22:15 +02'00'

Petrit Bilali — Digitally signed by Petrit Bilali — Date: 2026.09.02 15:11:05 +02'00'

Helidon Sokoli — Digitally signed by Helidon Sokoli — Date: 2026.09.02 15:18:07 +02'00'

Endri Haxhiu — Digitally signed by Endri Haxhiu — Date: 2026.09.29 13:41:18 +02'00'

Vulosur elektronikisht nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
Date: 2026/09/29 13:41:18 +03'00'
1d0ee8c2c01b4fbd8ed2699dc087167a2026092913432714040

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe firosur me anë të një proçedure automatike në një sistem elektronik (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore)